

Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e Ndhmës Juridike Falas në Kosovë dhe si mund të përmirësohen shërbimet e ndihmës juridike falas në Kosovë?

Më lejoni fillimisht të ndaj me Ju një storje të shkurtër personale, kjo vetëm pasi që përjetimet reale flasin dhe mishërohen më bukur se ato teorike, përmes tyre ne arrijmë të gjejmë dobësitë dhe këto dobësi kemi mundësinë për t'i kthyer në pika tona të forta. Në fakt ndjehem entuziaste dhe pushtohem e bëhem njeri sentimental sa herë filloj të hulumtoj e të shkruaj rreth kësaj natyre të ndihmës, padyshim të një rëndësie e vlere të posaçme për individin, në një situatë aspak të volitshme jemi ndeshur shumë kohë më parë në një rast ku ne nuk arrinim dot të angazhohim një mbrojtës, familja ime gjendej në një gjendje krejtësisht të rënduar ekonomike, atëkohë unë nuk arrita të kuptoja dot se ishte gabim i një organi gjegjës për mos-informim të drejtë se mund të ishim përfitues të po kësaj ndihme apo ishte thjesht një gabim i ynë se: 'ignorantia legis non excusat' (mos-njohja e ligjit nuk arsyeton).

Sidoqoftë, më duhet të zhvishem nga këto ndjenja dhe të filloj të shkruaj e të shoh nga një kënd tjetër.

- ❖ Shteti ynë Kosova, ashtu si vendet tjera pamëdyshje se ka bërë dhe vazhdon të bëjë përpjekje të vazhdueshme të sigurohet një qasje efektive në drejtësi, përmes institucioneve të autorizuar të ofroj ndihmën juridike falas për të gjithë qytetarët e saj të cilët nuk kanë mjete financiare të mjaftueshme për të siguruar përfaqësimin juridik apo kanë nevojë për këshilla juridike në çfarëdo procedure qoftë ajo: penale, civile, administrative apo në atë kundërvajtëse.

Analizuar në këtë vështrim institucionet që janë të ngarkuar sipas ligjit për të ofruar këtë lloj të ndihmës po arrijnë mjaft mirë ta bëjnë këtë, ndonëse jo çdoherë në nivelin e duhur.

Në këtë botëkuptim, konsideroj se disa nga mangësitë të cilat i kam listuar si më poshtë duhet kushtuar vëmendje dhe prioritet për të evituar sa më parë, në mënyrë që të kemi

një mekanizëm sa më funksional e të përshtatshëm për dhënien e ndihmës juridike falas për qytetarët në nevojë.

Mangësitë:

1. Rishikimi i plotë i kuadrit ligjor duke filluar nga: Kodi i Procedurës Penale në raport me Ligjin për Ndhimën Juridike Falas, të dyja këto ofrojnë zgjidhje të ndryshme për përfaqësim juridik, gjegjësisht në mes të dispozitave ligjore ka kundërthënie në mes tyre (shpejgim: respektivisht neni 58 i cili flet për Mbrojtësin me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar

1. Kur nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtjen e detyruar, të pandehurit i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesën e tij, nëse:

- 1.1. nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtje të detyrueshme e procedura penale zhvillohet për veprë penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim me tetë (8) ose më shumë vjet, ose*
- 1.2. këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënimi parashikuar, të dyshuarit apo të pandehurit me kërkesën e tij i caktohet mbrojtësi, në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t'i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij.*

Ndërsa, Ligji për Ndhimën Juridike Falas në nenin 4 Shtrirja dhe Llojet e Ndhimës Juridike Falas thotë se:

2. Ndhimja juridike falas ofrohet në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.

Për më tepër, KPP neni 58 pika 2 nuk autorizon në mënyrë të qartë se cili organ është i detyruar të njoftoj të pandehurin mbi këtë mundësi.

Ligji për Ndhimën Juridike Falas nuk bën dallimin në mes të rasteve penale që kërkojnë përfaqësim të detyrueshëm (Neni 57, KPP) dhe përfaqësim penal kur mbrojtja nuk është e detyruar (neni 58, KPP), e aq më tepër ky ligj nuk llogarit numrin e viteve të burgimit të mundshëm përderisa plotësohen të tri kriteret sipas nenit 6 të LNJF siç janë: kriteri kualifikues, financiar dhe kriteri juridik).

2. Buxheti jo i mjaftueshëm, mungesa e mjeteve financiare në buxhetin e Agjencisë për Ndhimën Juridike Falas, (respektivisht, nevoja për mbulueshmëri me

zyrtar shtesë në zyra rajonale, kjo bën të sigurohet një procedurë më e shpejtë dhe në kohë pa zvarritje, meqë vet zvarritja përbën shkelje).

- 3. Mos - informimi i qytetarëve mbi Ligjin e Ndhmës Juridike Falas nga ana e organeve dhe zyrtarëve kryesisht atyre administrativ (mungesë referimi nga ana e administratës publike mbi mundësinë e përfitimit të ndihmës juridike).** Po ashtu Policia, Prokurorët e Gjyqtarët duhet patjetër t'i informojnë të pandehurit në rastet penale për të drejtën e tyre për përfaqësim juridik falas në qoftëse të njëjtit plotësojnë kriteret e parapra sipas LNJF.
- 4. Qytetarët nuk janë të informuar mjaftueshëm mbi rolin dhe mundësitë që ofron Agjencia për Ndhmën Juridike Falas e aq më pak për vendodhjen e zyreve të agjencisë.**
- 5. Mos - ndarja e mjeteve financiare për shtrirje të gjithmbarshme të zyreve mobile në të gjitha regjionet.**
- 6. Angazhimi i strukturave përgjegjëse shtetërore për zbatimin efektiv të ligjit pa zvarritje.**

Ndihma Juridike Falas si një e drejtë vitale është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ashtu edhe me instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme në vendin tonë. Sigurisht se kategoria më e cënueshme janë dhe mbeten komunitetet më të pa favorizuara, komuniteti Ashkali, Romë e Egjiptian, komuniteti LGBTI, viktimat e dhunës në familje, andaj, në momentin e paraqitjes së ndonjë problemi juridik gjasat për të ndërmarrë ndonjë veprim për zgjidhjen e kontestit të tyre konsideroj se janë të pakta, kjo për shkak të mungesës së njohurive se ku të drejtohen, mos-posedimi i të hollave konsideroj se janë pengesa kyçe por jo vetëm, besimi i tyre i ulët se ndërmarrja e veprimit do të ndihmonte situatën në të cilën gjenden e në disa raste edhe niveli i ulët i arsimimit për të drejtat e tyre.

Sa i përket Përparësive të Ndhmës Juridike Falas janë të shumta, Kosova ka një listë jo të vogël avantazhesh, poshtëshënuara gjeni të renditura nga ato të cilat në perspektivën time mendoj se janë më të rëndësishmet:

-
- a) Mbështetja e një shtrese të popullësisë/Diskriminim pozitiv në zgjidhjen e kontestit të tyre juridik përmes shërbimeve të ndihmës juridike falas
 - b) Politikat e mira të përdorimit/shfrytëzimit të fondeve të donatorëve
 - c) Transparenca në menaxhimin financiar dhe në publikimin e raporteve dhe vendimeve nga ana e ANJF.
 - d) Puna e ekipore, serioziteti dhe profesionalizmi i zyrtarëve që ofrojnë ndihmën juridike falas.
 - e) Qasja në platformën online për plotësimin e aplikacionit për përfitimin e ndihmës juridike (ndihmajuridike.com)
 - f) Gjetja e donatorëve, fushatat e ndryshme vetëdijësuese, ditët informuese janë vetëm disa nga përparësitë që numri i kërkuesve të ndihmës juridike po rritet nga viti në vit.
 - g) E fundit, por jo për nga rëndësia, formimi i Klinikave Juridike përmes programit Kërko Drejtësi implementuar nga National Center for Courts ka mbështetur fuqishëm dhe ka dhënë akses më produktiv për të gjithë ata persona të cilët nuk mund të paguajnë avokat.
-

Si mund të përmirësohen shërbimet e ndihmës juridike falas në Kosovë?

Parimi i barazisë së armëve duhet të iu mundësohet të gjithë personave të cilët vendosen para një gjykate.

- ❖ Kuvendi vlerësoj se duhet rishikuar Kodin e Procedurës Penale, respektivisht nenin 58 i cili flet për Mbrojtësin me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar. Për më tepër KPP neni 58 pika 2 nuk autorizon në mënyrë të qartë se cili organ është i detyruar të njoftoj të pandehurin mbi këtë mundësi.

Ligji për Ndhmën Juridike Falas nuk bën dallimin në mes të rasteve penale që kërkojnë përfaqësim të detyrueshëm (Neni 57, KPP) dhe përfaqësim penal kur mbrojtja nuk është e detyruar (neni 58, KPP), e aq më tepër ky ligj nuk llogarit numrin e viteve të burgimit të mundshëm përderisa plotësohen të tri kriteret sipas nenit 6 të LNJF siç janë: kriteri kualifikues, financiar dhe kriteri juridik

- ❖ Konsideroj se çdo zyrë rajonale duhet të ketë mbulueshmëri me zyrtar shtesë nga një apo dy, kjo në mënyrë që personat të cilët gjenden në një pozitë të rëndë financiare t'u sigurohet një procedurë e drejtë dhe në kohë si dhe mbulueshmëri më e gjerë me zyre mobile
- ❖ Hulumtimi dhe gjetja e fondeve nga donatorët e ndryshëm
- ❖ Takime direkte me komunitetet të cilat nuk janë përdorues të rrjeteve sociale, pra të bëhet përpjekje që të identifikohen këta persona ku të njëjtit të informohen mbi shërbimet e ndihmës juridike falas
- ❖ Bashkëpunimi ndërinstytucional (institucionet me theks të veçuar ato të drejtësisë duhet kushtuar vëmendje dhe rëndësi më të madhe institucioneve që merren me dhënien e kësaj ndihme në veçanti Agjencisë për Ndihmën Juridike Falas)
- ❖ Mbajtja dhe organizimi i tryezave, debateve, organizimi i sesioneve informuese e diskutimeve të ndryshme nga ana e ANJF, Organizatave të ndryshme Joqeveritare dhe të ftohen studentët e Fakulteteve Juridike, avokatë...
- ❖ Përpilimi i broshurave, katalogëve, fletushka të ndryshme në mënyrë që të pasurohet sa më shumë opinioni i gjerë mbi ndihmën juridike falas, të krijohen video të ndryshme me mesazh sensibilizues.
- ❖ Shpërndarja e informacioneve për shërbimet e ndihmës juridike falas nëpërmjet mjeteve të komunikimit - internetit (rrjeteve të ndryshme sociale), TV, radio apo gazeta.
- ❖ Hartimi i pyetësorëve të ndryshëm për të parë se sa janë të informuar qytetarët mbi ndihmën juridike falas dhe sa prej tyre kanë shfrytëzuar këtë lloj ndihme.

- ❖ Pjesëmarrja e zyrtarëve në panairë të ndryshme të cilat zhvillohen nga institucionet e arsimit të lartë në vend meqë shpërndarja më e mirë e informacioneve mund të bëhet pikërisht nga të rinjtë/studentët.
- ❖ Të themelohen Zyra të Ndhmës Juridike Falas në Institucionet e Arsimit të Lartë (Universitete), të lidhen memorandum bashkëpunimi në mes të ANJF dhe Fakulteteve Juridike, kështu përveç përfitimeve tjera, studentëve të drejtësisë do t'u ofrohet mundësia e angazhimit si praktikant në këto zyre.
- ❖ Platforma online (ndihmajuridike.com) – është një mundësi e shkëlqyer, për të gjithë personat kërkues të ndihmës juridike falas, por besoj se e njëjta mund të jap një qasje ende më të lehtë për ne, gjegjësisht informatat, të dhënat për gjendjen financiare dhe statusin shoqëror mund të merren direkt nga organet të cilat posedojnë këto të dhëna (Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale) në mënyrë automatike nga vet sistemi, kjo shpie deri tek përdorimi më i thjeshtë i kësaj platforme nga ana e personave të rëndomtë duke shënuar numrin personal të tyre dhe duke u fokusuar vetëm në adresimin e problemit pa u marrur edhe me të dhëna të tjera.
- ❖ Krijimi i versionit të aplikacionit, me ç'rast një aplikacion i tillë të mund të shkarkohet, të inkuadrohen të gjitha informatat, raportet dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me ndihmën juridike falas si dhe përbrenda saj të krijohet mundësia e parashtrimit të pyetjeve nga ana e qytetarëve në mënyrë anonime.
Mund të ndodh që individët të presin me radhë në zyret që ofrojnë ndihmën juridike falas, që të mos krijohen pritje të tilla, në këtë aspekt mendoj se do të ishte mirë përbrenda këtij aplikacioni qytetarët të kenë mundësi të kyçen virtualisht direkt për bashkëbisedim me zyrtarët, avokatët (sigurisht veçmas për shkak të konfidencialitetit të rasteve).

E fundit por më e bukura është se secili nga ne mund të bëhemi pjesë e një ndryshimi të nevojshëm, fundja, është pikërisht zëri ynë ai i cili jep ngjyrë të drejtave tona.